



**DESHMI E TRASHEGIMISE LIGJORE**  
**NOTERE : ALBANA MAHMUTI (KARADAKU)**

Sot, me daten 26.11. 2014 (Dymije e Katërmbëdhjetë), në Zyren e Noterise Tirane, me seli në Rrugen "George W. Bush", Godina nr. 21, Zyra nr. 1, përpara meje Noteres Albana Mahmuti (Karadaku) ju paraqit personalisht:

**KERKUESE :** Zj. Sabrije BREGU, atesia Bek, amesia Bore, lindur në Tropoje me 26.08.1949 dhe banuese në Tiranë, Rruga "Budi", Njesia Bashkiake nr. 2, e paisur me Letër Njoftimin Biometrik me nr. Personal E95826148W.

**OBJEKTI :** Leshimi i Deshmise së Trashegimise ligjore për trashëgimlënesin Agron Bregu, atesia Hajdar, amesia Zenepe, lindur në Erseke me 17.02.1948 dhe me banim në Tiranë.

**BAZA LIGJORE : NENI 348 361 I KODIT CIVIL.**

Zonja Sabrije Bregu, ka paraqitur kërkesën pranë Zyres time të Noterise si dhe dokumentacionin e nevojshëm për çeljen e Deshmise së Trashegimise Ligjore të bashkeshortit së saj, të të ndjerit Agron Bregu, atesia Hajdar, amesia Zenepe, lindur në Erseke me 17.02.1948 dhe me banim në Tiranë.

Në bazë të Nenit 388, paragrafi i parë, kërkesja legjitimohet të kërkojë çeljen e deshmise së trashëgimise ligjore të bashkeshortit të saj, të të ndjerit Agron Hajdar Bregu.

Sipas çertifikates së vdekjes lëshuar me datën 07.11.2014 nga Zyra e Gjendjes Civile e Njesise Bashkiake nr. 2 Tiranë, rezultojnë se me datën 07.10.2014, në Tiranë ka vdekur shtetasi Agron Hajdar Bregu.

Sipas Nenit 318 të Kodit Civil "trashëgimia çelët në kohën kur vdes trashëgimlënesi dhe në vendin ku ai ka pasur banimin e tij të fundit. Ajo rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur".

Në bazë të Nenit 317 të Kodit Civil, trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënesi nuk ka lënë testament.

Nga verifikimi i bërë sipas ligjit në fuqi, trashëgimlënesi nuk ka lënë testament. Për këtë arsye, në bazë të Nenit 317 të Kodit Civil, për të përcaktuar rrethin e trashëgimtareve ligjore të të ndjerit dhe pjesët e tyre takuese nga pasuria e lënë në trashëgim, do të zbatohen rregullat e trashëgimise ligjore.

Gjithashtu rezultojnë që i njëjti të ketë pasur martesë tjetër, femije jashtë martese, të binesuar ose persona të tjerë në ngarkim, të jenë bërë të padenje për të trashëguar apo të jenë përjashtuar nga trashëgimia.

Në bazë të Nenit 361 të Kodit Civil në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijet dhe bashkeshortja.

Sa më sipër rezultojnë se të vetmit trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të të ndjerit Agron Hajdar Bregu, duke ju referuar Ligjit në fuqi janë bashkeshortja dhe djali i tij.

**PER KETE ARESYE, NE BAZE TE NENIT 348 E VIJUES TE K.CIVIL**

**V E N D O S A :**

Leshimin e Deshmise e Trashegimise Ligjore për trashëgimlënesin Agron Hajdar Bregu, duke caktuar si trashëgimtarë ligjorë të tij të radhës së parë :

1. Sabrije Bek Bregu - Bashkeshortja, lindur në Tropoje me 26.08.1949 dhe banuese në Tiranë, Rruga "Budi", me nr. personal E95826148W.
2. Mirvjen Agron Bregu - I Biri, lindur në Tiranë me 22.03.1985 dhe banues në Tiranë, Rruga "Budi", me nr. Personal I50322002B.

Të cilat trashëgojnë nga 1/2 (Një të dytën) pjesë secili të të gjithë pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të të ndjerit Agron Hajdar Bregu kudo ku ajo ndodhet. Në të njëjtin raport trashëgimtarët marrin përsipër edhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo trashëgimi.

Sa më sipër lartohet dhe nënshkruhet prej meje Noteres Albana Mahmuti (Karadaku) akti për lëshimin e deshmise së trashëgimise ligjore të trashëgimlënesit Agron Hajdar Bregu.

NOTERE  
Albana MAHMUTI (KARADAKU)